

Çka pritni nga ky workshop?

**Përgjigje e shpejtë**

Pjesëmarrësit ulen në rreth. Trajneri i njofton me rregullat dhe radhën e fjalës. \_\_\_\_\_ **Metoda** \_\_\_\_\_  
Pjesëmarrësit flasin sipas rregullave të dhëna.

Secili flet vetëm për veten e tij dhe përdor UNË në vend të dikush apo ne.  
Secili jep përgjigje të shkurta personale për pyetjen.  
Nuk ka diskutim apo komente në përgjigjet e të tjerëve.  
Kush nuk dëshiron të përgjigjet e kalon fjalën më tutje.

\_\_\_\_\_ **Rregullat** \_\_\_\_\_

Pllakat muri i përgatitur me rregullat e përgjigjes së shpejtë  
Shenja ngjitëse

\_\_\_\_\_ **Materialet** \_\_\_\_\_

**30 min**

## Mësimi në shkollat profesionale në fokus

**Përgjigjuni në 8 pyetjet vijuese.**

1. Çka ka ndryshuar në 5 vitet e fundit në shkollat profesionale?
2. Sa nxënës kanë mundësi të punojnë në profesionin të cilin e kanë mësuar?
3. Sa nxënës do të punojnë gjatë tërë jetës në profesionin e tyre?
4. Sa njohuri kanë nxënësit në përfundim të shkollimit të tyre?
5. Për sa kohë mjafton ajo që është mësuar në profesion?
6. Cilat kompetenca të pavarura nga profesioni do të duhej ti mësojnë nxënësit në shkollë?
7. Secili mësimdhënës i njeh pyetjet vijuese të nxënësve: „Pse duhet ta mësoj këtë“ ose „Pse më duhet kjo?“. Si do të duhej të paraqitej (prezantohej) mësimi në mënyrë që ai ta fitojë një domethënie të qartë?
8. A do të duhej që teoria dhe praktika të mësohen edhe më tutje ndaras? Si do të mund të dukej një mësim i tillë?

**Topi i borës ose metoda e pikës së djegies**

**Metoda**

---

- |                             |   |
|-----------------------------|---|
| 1. <b>Vetëm</b>             | Të lexohet dhe të përgjigjet në pyetje me shkrim                  |
| 2. <b>Partneritet</b>       | Të diskutohet dhe të bëhet dokumentimi i rezultatit të përbashkët |
| 3. <b>Grupi me 4 pers.</b>  | Të diskutohet dhe të dokumentohet rezultati i përbashkët          |
| 4. <b>Grupi me 8 pers.</b>  | Të diskutohet dhe të dokumentohet rezultati i përbashkët          |
| 5. <b>Grupi me 16 pers.</b> | Të diskutohet dhe të bëhet prezantimi me shkrim i përfunduar      |
| 6. <b>Plenum</b>            | Pjesëmarrësit prezantojnë rezultatin së bashku                    |

Tavolina për punë në grupe  
Kofer moderimi  
Letër

**Materialet**

---

**1h 45 min**

## Kërkesat e punës dhe profesionit

**Kompania juaj kërkon për një kohë sa më të shkurtër një punëtor të kualifikuar. Përvoja në punë nuk kërkohet në mënyrë eksplicite. Hartojeni një konkurs për një gazetë ditore.**

### Automekanik

Për këtë detyrë me përgjegjësi duhet ta keni përfunduar shkollimin për Automekanik si dhe të keni përvojë përkatëse në punë. Puna me ndërrime nuk do të duhej të paraqesë problem për ju. Personalisht karakterizoheni përmes një stili të pavarur dhe të besueshëm të punës. Nëse kërkoni shansin në një ambient ndërkombëtar dhe dinamik, i gëzohemi konkurrimit tuaj dhe dialogut me ju.

### *Ky është profili juaj*

Shkollimi juaj është Elektromekanik, Mekanik i industrisë, Mekanik i makinave bujqësore ose të ndërtimitarisë apo Automekanik dhe ideale do të ishte të posedoni përvojë pune shumëvjeçare në Elektroteknikë/Elektronikë, Hidraulikë dhe Mekanikë të përgjithshme. Pasi që na flenë në zemër kënaqja e klientëve tanë, presim nga ju aftësi të theksuara komunikimi me klientët. Për të mundur ti kryeni detyrat që janë në përgjegjësinë tuaj, posedoni aftësi të mira për menaxhimin e kohës dhe tregoni gatishmëri të lartë të angazhimit në punë. Posedoni patentë shoferin e klasit III (B) dhe dini ta përdorni kompjuterin.

### *Kjo ju pret*

Ju do të merrni përsipër mirëmbajtjen dhe riparimin e produkteve tona me kërkesa të larta teknike duke pasur parasysh rregullat e parandalimit të fatkeqësive dhe do të bëni konstruksione të jashtëzakonshme (pajisje shtesë) sipas skicave dhe udhëzimeve teknike. Ju jeni në gjendje të udhëhiqni me automobilin për shërbimin e klientëve duke përfshirë veglat dhe të mirat materiale dhe punoni me kompjuterin tuaj të pavarur dhe me përgjegjësi personale.

### PowerPoint

7. Pjesëmarrësit formojnë grupe specifike sipas profesionit dhe diskutojnë për konkurset e paraqitura
8. Secili grup përpilon një përshkrim të punës sipas titujve në vijim:
  - Përshkrimi i kompanisë
  - Detyrat e profesionistit
  - Profili i profesionistit
9. Secili grup përgatit një Power point prezantim.
10. Rezultatet e punës së grupeve do të prezantohen dhe do të diskutohen në plenum.

---

**Metoda**

Tavolina për punë në grupe

Letër (Pllakat), Tabelë apo Flipchart, ose kartolina metaplan

Kofer moderimi

---

**Materialet**

Kompjuter dhe video-projektor

Shtojca, Përshkrimi i vendit të punës nga Interneti [www.monster.de](http://www.monster.de)

Shtojca, Mindmap Kualifikimet kyçe

**1h 30 min**

## Kërkesat e punës dhe profesionit

### Teknik (m/f) për Elektrikë ose Mekanikë

#### Detyrat tuaja:

- Marrja përsipër e përkujdesjes teknike gjithëpërfshirëse të sistemit të një versioni të aeroplanit sa i përket përpunimit të reklamacionit dhe përgatitjes së punës.
- Analizimi i reklamimit të prodhimit në aspektin teknik
- Gjetja e zgjidhjes në bazë të dokumenteve të ndërtimit që janë në dispozicion për rrjedhën e prodhimit dhe fazën serike
- Planifikimi dhe montimi i pakos së punës për prodhimin
- Planifikimi i termineve, ngarkimi i materialeve dhe vënia në dispozicion e dokumenteve të ndërtimit
- Planifikimi i pavarur i tërësishëm i rrjedhës së prodhimit dhe hartimi i planeve të punës sipas pikëpamjes ekonomike duke pasur parasysh pjesërisht teknologjinë e re të prodhimit në montimi strukturor të A 380
- Optimizimi i vazhdueshëm i procesit të prodhimit në pajtim me sigurimin e kualitetit

#### Profili i juaj:

- Teknik ose Mjeshtër në lëmin e Elektrikës ose Mekanikës
- Përvojë në përgatitjen e punës në makineri
- Njohuri të mira të gjuhës angleze në të folur dhe shkruar
- Njohuri në SAP, niveli i dëshiruar (PP dhe MM)
- Fleksibilitet ,
- Aftësi për të punuar në ekip

---

Shtojcë

### Teknik i Elektronikës së pajisjeve energjetike

#### Detyrat tuaja

- Përpunimi i pavarur i të gjitha detyrave të shtruara nga elektroteknika dhe sistemi i komandimit nga prodhimi dhe lëmi teknik i ndërtesës.
- Planifikimi, ndërtimi dhe instalimi i sistemit të komandimit dhe aparaturave
- Planifikimi, sigurimi dhe vënia në përdorim e pajisjeve dhe veglave si dhe këshillimi profesional në çështjet elektroteknike
- Mirëmbajtja dhe riparimi i pajisjeve elektrike, makinave dhe veglave
- Provimi i sigurimit teknik të veglave dhe pajisjeve
- Gatishmëria për t'iu përgjigjur thirrjes, veçanërisht për zgjidhjen e problemeve në lëmin e elektrikës
- Kujdesi profesional dhe koordinimi i kompanive të huaja në lidhje me elektroteknikën dhe teknikën e komandimit

#### Kërkesat tona

Ju keni përfunduar suksesshëm shkollimin për Elektroinstalues / Elektronist i pajisjeve të energjisë (m/f) dhe posedoni përvojë në lëmin e mirëmbajtjes së pajisjeve industriale ose pajisjeve të mëdha elektrike, si dhe njohuri të mira në komandat e programuara (-SPS).

Me kënaqësi punoni të pavarur dhe gjithashtu në grup, posedoni aftësi për zgjidhjen e problemeve komplekse që parashtrihen si dhe mënyrë të kujdesshme dhe korrekte të punës.

Nëse besoni se jeni të kualifikuar për këtë vend pune dhe e shihni ardhmërinë tuaj profesionale në ndërmarrjen tonë, gëzohemi për arritjen e dokumenteve tuaja për konkurrim.

## Kërkesat e punës dhe profesionit

### SHK/Elektro

Ne i fascinojmë klientët tanë dhe ndërtojmë një ardhmëri më të mirë. Vlerat tona qëndrojnë në: Integritet, guxim për ndryshim, punë në grup dhe angazhim të madh. Për profesionistë të ndërtimitarisë ofrojmë zgjidhje inovative me vlera të menduara shumëfish.

Për regjionin e gjerë të Osnabrück-ut kërkojmë një këshilltar të shitjes (m/f)

#### *Përgjegjësitë tuaja*

- Analizimi sistematik i tregut dhe klientëve sipas strategjisë së shitjes dhe marketingut.
- Kujdesi intensiv, këshillimi dhe shkollimi i klientëve nga lëmi SHK/ i Elektros
- Prezantimi i produkteve, importeve dhe përpunimi i projektit
- Pranimi i klientëve të kompanisë, hartimi i ofertave, negocimi i marrëveshjeve, përpunimi i dokumentacionit

#### *Profili i juaj*

- Shkollimi përkatës për teknik apo mjeshtër në lëmin e SHK / Elektro
- Përvojë profesionale, ideale do të ishte në shitje/këshillim për prodhime teknike
- I gatshëm për veprimtari në shërbim të jashtëm dhe në kontakt me klientët.

### Mekanik / Mjeshtër / Teknik i Automjeteve dhe Kamionëve

#### *Detyrat tuaja*

Ju u përgjigjeni kërkesave teknike të punëtorive, për të ndihmuar shpejtë dhe në mënyrë efikase në riparimin e automjeteve ose në përpunimin e dokumentacionit teknik për servisim dhe riparim si dhe për kalkulimet. Do të përkrahni mekanikët përmes ndërmjetësimit të informatave teknike të cilat i keni të njohura apo i merrni nga literatura aktuale teknike. Ju punoni në grup dhe shkëmbeni idetë dhe njohuritë teknike me kolegët tuaj.

#### *Profili juaj*

Ju do të duhej të keni shkollim adekuat për Teknik te Automjeteve (Elektricitist, Mekanik, Teknik i shërbimit, Mjeshtër) dhe do të duhej të kishit mbledhur disa vite përvojë pune. Ideale do të ishte që të kishit njohuri në lëmin e diagnostifikimit dhe riparimit për automjetet në përgjithësi dhe të mund ti implementoni këto në mënyrë të pavarur. Nëse dëshironi që në të ardhmen të koncentrohni plotësisht në analizimin dhe zgjidhjen e çështjeve teknike, ose kërkonin një vend pune modern dhe të orientuar në ardhmëri, atëherë jeni drejtuar në vendin e duhur

#### *Njohuritë e dëshiruara*

Njohuri të përgjithshme dhe kompjuterike: Njohuri të mira, Përvojë:2-3 vite

#### *Njohuritë teknike*

Makinat/Motorët/ Mekatronikë e automjeteve, Përvojë: 3 - 5 vite

#### *Shkollimi i dëshiruar*

-Mekanik i motorëve, automjeteve, Matura: Përfundimi i maturës, Nota: e mirë

#### *Përvoja e dëshiruar profesionale*

Industria automobilistike, Makineri, Përvojë 3-5 vite

---

Shtojcë

## Kërkesat e punës dhe profesionit

### **Rrobaqepës/e, në shërbim të jashtëm (jo në shitje)**

#### ***Detyrat tuaja***

Puna juaj do të zgjasë përafërsisht 2 javë dhe do të jetë në qytetin Fulda. Pastaj do të jeni të angazhuar kryesisht në shërbim të jashtëm me detyrën kryesore marrja e masës së veshjeve të sigurisë tek klientët tanë në gjithë Bavarinë (jo shitje). Për këtë detyrë do tu jepet në dispozicion një automjet i kompanisë dhe një telefon mobil. Terminet me klientët dhe fjetjet në vende të ndryshme do të organizohen, ndërsa shpenzimet e fjetjes i merr përsipër kompania. Ju lutemi që të paraqiten vetëm femrat, meqenëse duhet të merret masa e veshjeve të femrave!


#### ***Profili juaj***

Me përparësi është shkollimi i përfunduar për Rrobaqepëse, ndërsa për ata që nuk i përkasin profesionit kanë mundësinë e praktikës intensive. Ju jeni shumë fleksibil dhe mobil, meqenëse vendi i aktivitetit tuaj do të jetë në regjionin e Gjermanisë jugore ( me fjetje). Një masë e madhe e vetpërgjegjësisë.

---

**Shtojcë**

## Kërkesat e punës dhe profesionit



Shtojca

## Kërkesat e punës dhe profesionit

**Hartoni një rangim (renditje) kompetencash për lëmin e profesionit tuaj. Arsyetojeni zgjedhjen tuaj.**

	Veprimet	Kompetencat	Argumentimi
1	Argumentohet	Kompetencat personale	Sjellja me klientët
...			
10	Pranimi i domosdoshmërisë për shkollim të mëtutjeshëm	Kompetencat metodike dhe mësimore	Ndryshimet e shpejta në ekonomi dhe shoqëri

### Metaplan

#### Faza 1

1. Duhet të formohen grupe të orientuara në profesion.
2. Secili grup harton një rangim (shkallëzim) të kompetencave të orientuar në profesion. Duhet të emërohen së paku 10 kompetenca vepruese .
3. Kompetencat e zgjedhura (shih shembujt në dokumentin shtesë) të ndara veçmas dhe me ngjyra janë të shkruara në kartelat në këndin e djathtë.
4. Rangimi do të ngjitet në radhitje zbritëse në pinboard.
5. Grupet e zgjedhura e prezantojnë dhe arsyetojnë zgjedhjen e tyre.
6. Në plenum do të krahasohen dhe analizohen rezultatet e grupeve.

#### Faza 2

7. Grupet krahasojnë rangimin e kompetencave me qëllimin edukativo-arsimor të shkollës profesionale (nga kurrikuli).
8. Njohuritë diskutohen shkurtimisht në plenum.

### Metoda

### Kurrikulet

Tavolina për punë në grupe

Kartolina metaplan

- Këndi i djathtë
  - Ngjyra A (e gjelbër) Kompetencat profesionale
  - Ngjyra B (e kuqe) Kompetencat personale
  - Ngjyra C (e bardhë) Kompetencat sociale
  - Ngjyra D (e kaltër) Kompetencat mësimore dhe metodike

### Materialet

## Kërkesat e punës dhe profesionit

### Kompetencat profesionale

Zbatimi i rregullave dhe veprimeve  
 Njohja e kontekstit të përbashkët të sistemit dhe procesit  
 Përcaktimi i zgjidhjes së problemeve dhe hapave të punës  
 Formulimi i kërkesave të produktit  
 Dokumentimi i operimeve të pjesërishme dhe rezultateve  
 Vlerësimi i rezultateve  
 Optimizimi i procesit apo rrjedhës së punës  
 Kryerja racionale dhe e orientuar në qëllim e punës  
 Zhvillimi i propozimeve për përmirësim  
 Sigurimi i kualitetit  
 Zgjedhja e metodës / apo veglës  
 Përcaktimi dhe vlerësimi i parametrave të procesit  
 Prezantimi i rezultateve të punës  
 Hartimi i planeve ose programeve të veprimit  
 Përdorimi i makinave në mënyrë të duhur  
 Analizimi i dokumentacionit teknik  
 Vlerësimi i produkteve nga pikëpamja ekonomike dhe ekologjike  
 Disponimi fleksibil  
 Përcaktimi i të dhënave teknologjike  
 Pasja parasysh e normave dhe rregulloreve  
 Interpretimi i simboleve  
 Pasja parasysh e masave për mbrojtjen e shëndetit në punë  
 u. v. a. m.

### Kompetencat personale

Bartja e bashkëpërgjegjësisë  
 Argumentimi me fakte  
 Njohja e problemeve dhe kontributi për zgjidhjen e tyre  
 Artikulimi i nevojave dhe interesave  
 Pozicionimi fleksibil në situatat e reja  
 Zbatimi i vetëkontrollit  
 Durimi situatave të tensionuara  
 Lërja anash e interesave personale në raport me grupet e synuara  
 Ushtrimi i kritikës dhe vetëkritikës  
 Ndërtimi i besimit  
 Forcimi i vetëbesimit dhe vetëdijes  
 Negocimi me autoritet  
 Ndërtimi i gjykimit me përgjegjësi  
 Përdorimi i gjuhës profesionale  
 Planifikimi dhe implementimi i pavarur  
 u. v. a. m.

---

**Shtojcë**

## Kërkesat e punës dhe profesionit

### Kompetencat sociale

Shkëmbimi i informatave  
 Bartja e përgjegjësisë sociale  
 Të kihet konsideratë  
 Integrimi në procese dinamike grupore  
 Tolerimi i pikëpamjeve të ndryshme  
 Puna kooperative  
 Dhënja e ndihmës  
 Kyçja në punë grupore  
 Përkrahja e bashkëpunimit  
 Formimi i proceseve dinamike grupore  
 Kuptimi dhe interpretimi i lidhjeve dhe veprimeve sociale  
 u. v. a. m.

### Kompetencat metodike dhe mësimore

Zbatimi i teknikave mësimore  
 Gjykimi analogjik  
 Njohja e problematikës dhe qëllimeve  
 Përmbledhja e rezultateve  
 Artikulimi i detyrave komplekse  
 Përkufizimi i problemeve  
 Hulumtimi i sistemeve ose gjendjeve  
 Vlerësimi i realizueshmërisë së zgjidhjeve  
 Gjetja dhe vlerësimi i alternativave  
 Zgjedhja e mënyrës së punës  
 Përkufizimi sistematik i gabimeve  
 Caktimi i rezultateve dhe metodave  
 Kontrollimi i arsyeshëm i njohurive  
 Zbatimi i teknikave kreative  
 Zhvillimi i formulave  
 Zhvillimi i strategjive mësimore  
 Njohja e llojit të përshtatshëm mësimor  
 Puna ose mësimi me koncentrim  
 Transferimi i njohurive dhe metodave  
 Zhvillimi i pavarur i informatave  
 Analizimi ekonomik i informatave  
 Strukturimi dhe paraqitja e informatave  
 Hartimi i rregullave të vlerësimit  
 Sjellja e përshtatshme me mediat  
 Dallimi i të rëndësishmes prej të parëndësishmes  
 Vlerësimi i planeve dhe nëse është nevoja revidimi i tyre  
 Gatishmëria për mësim gjatë gjithë jetës (LLL)  
 Analizimi i dokumentacionit  
 Përcjellja e informatave  
 Përgatitja e shënimeve  
 Transferimi i të mësuarit në problemet e reja  
 Shtrimi i pyetjeve kuptimore  
 Marrja e vendimeve  
 Gjetja e burimeve të informimit  
 Qasja e përcjellur me metoda, sistematike, në ndarje të punës dhe e drejtë.  
 Përcaktimi qëllimit dhe kohës  
 Hartimi i planeve ose ndryshimi fleksibil i tyre  
 Zhvillimi i strategjive të zgjidhjes, etj.


---

**Shtojcë**


## Kërkesat e punës dhe profesionit

### Ndryshimi në arsimin profesional

Prej ekspertit profesional tek kompetencat vepruese profesionale



### Kompetencat vepruese



Shtojcë